

PËRSHKRIM PUNE

Institucioni:	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
Drejtoria:	Drejtoria e Regjistrit të Zhvillimit të Territorit
Sektori:	Sektorit të Regjistrit të Zhvillimit të Territorit
Titulli i Punës:	Përgjegjës sektori
Kategoria:	III A/1

Përgjegjësitë kryesore:

Qëllimi i Punës e Përgjegjësit e Sektorit të Regjistrit të Zhvillimit të Territorit janë të sigurojë se qëllimi i punës dhe detyrat e caktuara për drejtorinë zbatohen me efektivitet dhe në kohë sipas legjislacionit në fuqi, procedurave të caktuara, planeve dhe afateve të miratuara.

Detyrat:

Përgjegjësi i Sektorit të Regjistrit të Zhvillimit të Territorit është përgjegjës për veprimtaritë si më poshtë:

- Organizon, drejton, koordinon, administron, monitoron dhe vlerëson punën e stafit nën përgjegjësinë e tij/saj;
- Shpërndan punën mes specialistëve të sektorit sipas detyrave përkatëse të caktuara dhe udhëzimeve të drejtorit të drejtorisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm;
- Shqyrton, miraton dhe dorëzon tek Drejtori i Drejtorisë dhe tek Drejtori i Përgjithshëm dokumentet dhe materialet e prodhuara nga stafi nën përgjegjësinë e tij;
- Propozon, nëse e sheh të nevojshme, masa disiplinore për personelin e sektorit;
- Bashkëpunon me sektorët e tjerë të AKPT-së për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që lidhen me qëllimin e punës së drejtorisë;
- Shqyrton, miraton dhe paraqet tek drejtori i drejtorisë propozime për vendosjen e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe për anëtarësimin në organizata ndërkombëtare që veprojnë në sektorë të njëjtë që janë pjesë e qëllimit të punës së Sektorit të Gjeomatikës dhe Regjistrit të Planifikimit;
- Shqyrton dhe paraqet tek Drejtori i Drejtorisë projekt akte nënligjore dhe rregullore që lidhen me çështjet që mbulohen nga sektori;
- Merr pjesë në konferenca, seminare, kurse trajnimi për gjeomatikën dhe regjistrin e planifikimit për të përmirësuar aftësitë e tij/saj profesionale;

- Promovon pjesëmarrjen e personelit të drejtorisë në konferenca, seminare, kurse trajnimi për gjeomatikën dhe regjistrin e planifikimit për të përmirësuar aftësitë e tyre;
- Merr pjesë në Komisione apo grupe pune të ngritura me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm;
- Të marrë pjesë në komitetet ad-hoc, të cilat krijohen nën drejtimin e AKPT-së, përbërja e të cilave përcaktohet me urdhër të Kryeministrit, sipas propozimit të ministrit që mbulon planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit. Këto komitete ushtrjnë funksione këshillimore për Bordin e Gjeoinformacionit, si dhe u paraqesin rekomandime me shkrim Bordit të Gjeoinformacionit në lidhje me:
 - monitorimin e zbatimit të standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS sipas përcaktimeve të vendimit nr.459, datë 16.6.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS”;;
 - ndryshimin e strukturës të së dhënave dhe të metadatave;
 - paraqitjen e e propozimeve Bordit të Gjeoinformacionit për pranimin e standardeve të reja gjeodezike dhe GIS, si dhe për përditësimin e tyre.
- Kryen detyra të tjera përkatëse që i caktohen.

Arsimi, njohuritë, aftësitë, përvoja:

- Të ketë mbaruar arsimin e lartë në një nga këto degë: inxhinieri ndërtimi, gjeodezi ose degë të ngjashme me to
- Të ketë të paktën 4 vjet përvoja pune të ngjashme
- Të ketë njohuri të mira të parimeve dhe praktikave të planifikimit urban dhe të territorit
- Të ketë njohuri të të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Shqipëri
- Të zotërojë gjuhën angleze (me dëshmi) përveç gjuhës shqipe
- Të përdorë programet bazë të punës në kompjuter dhe aplikacioneve si AutoCAD, Word, Excel, GIS
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe menaxhuese
- Të jetë i/e aftë të përpilojë, analizojë dhe përgatisë raporte dhe të dhëna teknike që lidhen me planifikimin
- Të ketë aftësi në vendosjen dhe ruajtjen e marrëdhënieve efektive të punës me punonjësit.